

FJALA PËRSHËNDETËSE

I Nderuar Z. Haldeda

I Nderuar Z. Leskaj

I Nderuar Z. Zhilla

I Nderuari Z. Shera

Të nderuar pjesëmarrës në këtë Konferencë!

Në radhë të parë dua t'ju falenderoj dhe t'ju uroj mireseardhjen.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit e organizon këtë Konferencë në kuadrin e 100 Vjetorit të shpalljes së Pavarësië. 28 Nëntori i vitit 1912 është ngjarja më e rëndësishme në historinë e popullit tonë, sepse ajo shënoi themelimin e Shtetit Shqiptar dhe hapi rrugën e zhvillimit dhe të sukseseve që populli ynë ka arritur në këto 100 vite dhe veçanërisht në dy dekadat e fundit, me vendosjen e sistemit të ekonomisë së tregut dhe demokracisë.

Zhvillime dhe arritje kemi patur në të gjitha fushat, ekonomike, politike, shoqërore dhe kulturore. Me kënaqësi mund të themi se zhvillime dhe arritje kemi patur edhe në fushën e kontabilitetit.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, një organizëm profesional, publik dhe i pavarur, me punën e tij në vite ka fituar mbështetjen dhe vlerësimin e profesionistëve të fushës së kontabilitetit dhe unë me krenari në emër të tij u shpreh mirënjohje të gjithë atyre që në vite kanë punuar dhe kontribuar në zhvillimin dhe arritjet kësaj fushe të shkencës ekonomike.

Në këto dy dekadat e fundit u kryen reforma të thella në këtë fushë, që çuan në krijimin dhe përsosjen e kuadrit ligjor e rregullator. Për arritjen e këtyre rezultateve një mbështetje të madhe kemi patur në vijimësi nga Qeveritë dhe Minsitria e Financave.

Do të kemi mundësi sot në këtë sallë që përmes referateve që do të prezantohen, të njihemi jo vetëm arritjet e deritanishme por ajo që është më e rëndësishme të bëhen të ditura për të gjitha palë e interesuara, edhe rrugët që do të ndiqen për realizimin e strategjisë për të ardhmen e KKK.

Duke Ju uruar dhe një herë përzemërsisht për vëmendjen dhe interesimin Tuaj për të marrë pjesë në këtë konferencë, më lejoni t'ju uroj konferencës suksese dhe punë të mbarë!